



Më
Dana 22-06-2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri me procesmbajtësen Drita Ejupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Komuna Ferizaj, i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, sipas propozim akuzës – kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të evidentuar si: PP/II.nr.611-1/18 të datës 27 mars 2018, më 25 prill 2018 mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me kërkesë për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, të evidentuar si: PP/II.nr.611-1/18 të datës 27 mars 2018, gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED], i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në rrugën [REDACTED], Shtime, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, student, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 20 shkurt 2018, rreth orës 16:00, në rrugën "Tahir Sinani", Shtime, për shkak të një mosmarrëveshje në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit [REDACTED] derisa i dëmtuari ishte duke punuar në ëmbëltooren "Nven", kishte shkuar i pandehuri dhe i njëjti iu kishte drejtuar me

fjalët "Hajde jashtë te dera e lokalit", me të dalë jashtë e kishte sulmuar fizikisht duke e goditur me grushte në fytyrë, me ç'ka të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përkohshme në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 20.03.2018,-

- me të cilin veprim ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë shënuar dhe bazuar në dispozitën e nenit 4,7,17,23,41,42.43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së të pandehurin:

GJYKON

DËNIM ME GJOBË në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim sipas nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së, i njëjti do i shndërrohet në dënim burgimi, ashtu për çdo njëzet (20) € do t'i llogaritet një (1) ditë burgimi.

I dëmtuari [REDAKTUAR] me vendbanim rr." [REDAKTUAR] ", komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej njëzetë (20) €, paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20) €, si dhe shumën prej tridhjetë (30) për programin për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit të detyruar.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.611-1/18 të datës 27 mars 2018, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe procedura hetimore që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të propozim akuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrin ndëshkimor në kuptim të nenit 495 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Me rastin e vlerësimit të provave materiale të bashkangjitura si në shkresat e lëndës si: raporti fillestar i incidentit nr. 2018-AU-34, raporti i policit nr. 2018-AU-34, akt ekspertimin mjeko – ligjor të datës 20 mars 2018 dhe prova tjera që gjinden në shkresat e lëndës, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë.

Gjykata vlerëson se këto prova janë bindëse dhe të bazuara, të cilat vërtetojnë se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet me aktakuzën e Prokurorit të Shtetit.

Konform nenit 463 paragrafi 2 të KPPRK-së, të dëmtuarit [REDAKTUAR] me vendbanim rr. [REDAKTUAR], komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej njëzetë euro (20.00) €, paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20) €, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit taksën në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL

P.nr. 454/18

Datë: 25 prill 2018

Procesmbajtësja,

Drita Ujupi

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, kësaj gjykate, në afat prej tetë (8) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.